

URDHËR
Nr. 14, datë 20.1.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) 16,
“QIRATË”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit financiar (SNRF)16, “Qiratë”.
2. Ndryshimet e SNRF 16, “Qiratë”, të publikuara në shtator 2022, do të zbatohen për periudhat raportuese që fillojnë më 1 janar 2024, po lejohet zbatimit i mëhershëm me kusht që të jepen shënimet e duhura shpjeguese.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

DETYRIMI PËR QIRANË NË NJË SHITJE DHE MARRJE MË PAS ME QIRA NDRYSHIME NË SNRF 16

Ndryshime në SNRF 16 *Qiratë*

Janë shtuar paragrafët 102A, C1D dhe C20E dhe është ndryshuar paragrafi C2. Para paragrafit C20E është shtuar një titull i ri. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Transaksionet e shitjes dhe të marrjes më pas me qira

...

Vlerësimi nëse transferimi i aktivit është një shitje

...

Transferimi i aktivit është një shitje

...

102A Pas datës së fillimit, një shitës-qiramarrës do të zbatojë paragrafët 29–35 për të drejtën e përdorimit të aktivit që vjen nga marrja më pas me qira dhe paragrafët 36–46 për detyrimin për qiranë që vjen po nga marrja më pas me qira. Kur zbaton paragrafët 36–46, një shitës-qiramarrës do të përcaktojë ‘pagesat e qirasë’ ose ‘pagesat e rishikuara të qirasë’ në një mënyrë që shitësi-qiramarrës nuk do të njohë ndonjë shumë nga fitimi apo humbja që lidhet me të drejtën e përdorimit të mbajtur nga shitësi-qiramarrës. Zbatimi i kërkesave të këtij paragrafi nuk e pengon shitësin-qiramarrës nga njohja në rezultat e një fitimi apo humbjeje të lidhur me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të një qiraje siç kërkohet nga paragrafi 46(a).

...

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

...

C1D *Detyrimi për Qiranë në një Shitje dhe Marrje më pas me Qira*, i publikuar në shtator 2022, ndryshoi paragrafin C2 dhe shtoi paragrafët 102A dhe C20E. Një shitës-qiramarrës do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2024 e më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një shitës-qiramarrës i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ai duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

C2 Për qëllime të kërkesave në paragrafët C1–~~C20E~~–C19, data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore raportuese për të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këtë Standard.

Detyrimi për qiranë në një shitje dhe marrje më pas me qira

C20E Një shitës-qiramarrës do të zbatojë *Detyrimin për Qiranë në një Shitje dhe Marrje më pas me Qira* (shih paragrafin C1D) në retrospektivë në përputhje me SNK 8 për transaksione të shitjes dhe marrjes më pas me qira të ndodhura pas datës së zbatimit për herë të parë.

Lease Liability in a Sale and Leaseback

Amendments to IFRS 16

Amendments to IFRS 16 Leases

Paragraphs 102A, C1D and C20E are added and paragraph C2 is amended. A new heading is added before paragraph C20E. New text is underlined, and deleted text is struck through.

Sale and leaseback transactions

...

Assessing whether the transfer of the asset is a sale

...

Transfer of the asset is a sale

...

102A After the commencement date, the seller-lessee shall apply paragraphs 29–35 to the right-of-use asset arising from the leaseback and paragraphs 36–46 to the lease liability arising from the leaseback. In applying paragraphs 36–46, the seller-lessee shall determine ‘lease payments’ or ‘revised lease payments’ in a way that the seller-lessee would not recognise any amount of the gain or loss that relates to the right of use retained by the seller-lessee. Applying the requirements in this paragraph does not prevent the seller-lessee from recognising in profit or loss any gain or loss relating to the partial or full termination of a lease as required by paragraph 46(a).

...

Appendix C

Effective date and transition

Effective date

...

C1D *Lease Liability in a Sale and Leaseback*, issued in September 2022, amended paragraph C2 and added paragraphs 102A and C20E. A seller-lessee shall apply these amendments for annual reporting periods beginning on or after 1 January 2024. Earlier application is permitted. If a seller-lessee applies these amendments for an earlier period, it shall disclose that fact.

Transition

C2 For the purposes of the requirements in paragraphs C1–~~C20E~~–C19, the date of initial application is the beginning of the annual reporting period in which an entity first applies this Standard.

...

Lease liability in a sale and leaseback

C20E A seller-lessee shall apply *Lease Liability in a Sale and Leaseback* (see paragraph C1D) retrospectively in accordance with IAS 8 to sale and leaseback transactions entered into after the date of initial application.